



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFIË



**PROGRAM**

Drejtimi: **Master Profesional Gjeografi**

**Lënda: SEMINAR NË GJEOGRAFINË RAJONALE TË SHQIPËRISË**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Gjovalin Gruda
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (1.5 leksione dhe 2 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Programi i studimit:</i>	Master Profesional Gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

**Shkurtesë:** Lënda synon zgjerimin dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive në studimin e potencialeve fiziko-gjeografike në drejtim të shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social-ekonomik. Karakteri kompleks i këtyre njohurive sintetizohet në përcaktimin e rajoneve fiziko-ekonomike të cilat trajtohen mbi bazën e raporteve të ekuilibruara midis shoqërisë njerëzore dhe pasurive natyrore. Kuadri i këtyre njohurive priret për një trajtim të integruar dhe në bashkëveprim të përhershëm të dukurive gjeografike e natyrore, zhvillimit ekonomik, human etj, në bazën e njohjes së ligjësive që i drejtojnë këto dukuri. etj.

**Temat e leksioneve:**

1. Koncepti i sotëm mbi rajonin dhe zhvillimet rajonale e mundësia e aplikimit të tyre në Gjeografinë Rajonale të Shqipërisë.
2. Uniteti natyror, etnik, historik dhe kulturor i hapësirave gjeografike shqiptare.
3. Riformulimi mbi bazën e konceptit të sotëm të rajonit e rajonizimit të faktorëve të diferencimit rajonal të hapësirës gjeografike shqiptare.
4. Vështrim historik mbi diferencimin rajonal të hapësirës sonë gjeografike.
5. Veçoritë dhe karakteristikat kryesore të rajoneve gjeografike të Shqipërisë.
6. Treguesit kryesorë të zhvillimit të pabarabartë të rajoneve në Shqipëri.
7. Evidentimi i shkaqeve të zhvillimit të pabarabartë të rajoneve në Shqipëri.
8. Pasojat e pabarazive të theksuara në zhvillimet rajonale në vendin tonë.
9. Zonat malore, koncepti, veçoritë dhe drejtimet e zhvillimit social-ekonomik.
10. Proçesi i braktisjes masive të zonave malore në Shqipëri dhe pasojat social-ekonomike, mjedisore dhe peizazhore.
11. Litoralizimi i popullsisë dhe ekonomisë në Shqipëri, zhvillimet e sotme dhe perspektiva.
12. Masat që duhen marrë për zhvillime proporcionale dhe të harmonizuara të rajoneve të Shqipërisë.
13. Roli diktues i qyteteve kryesore në zhvillimin social-ekonomik të rajoneve në Shqipëri. Raportet qendër-periferi dhe rajonet polare.
14. Rajonizimi administrativo-territorial i RSH, si premisë për zhvillimi rajonal të harmonizuar.
15. Zhvillimet globale dhe rajonale. Identiteti shtetëror, kombëtar, ballkanik, europian dhe “ qytetar i botës”.

**Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve

- <i>Angazhimi në seminare:</i>	10% e notës
- <i>Testi I: në javën e 6-të</i>	10% e notës
- <i>Testi II: në javën e 10-të</i>	10% e notës
- <i>Detyra e kursit ose ese: deri në 15 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):</i>	20% e notës
- <i>Konrolli përfundimtar: provim me shkrim</i>	50% e notës
- <i>Gjithsej:</i>	100%

**Literatura bazë:**

1. Gjeografia Fizike e Shqipërisë (Monografi), vëllimi I dhe II, QSGJ, ASH, Tiranë 1990,1991.
2. Laçi S., Sheme S., Gjeografia humane e Shqipërisë. ERIK. Tiranë 2005.
3. Goler D., Sfidat e zhvillimeve rajonale në Shqipëri dhe eksperiencia gjermane. Konferenca Ndërkombëtare. Tiranë 2012.
4. Karaguni M., Tkurrja e qytezave malore dhe alternativat e zhvillimit. Studime Albanologjike IV. Tiranë 2011.
5. Sirika Sh., Doka Dh., Braktisja e zonave malore në Shqipëri nëpërmjet emigrimit dhe efektet e këtij procesi për zhvillimin e ardhshëm të tyre. Studime Albanologjike IV. Tiranë 2011.
6. INSTAT, Shqipëria, tendencat e varfërisë dhe pabarazia 2002-2003, Tiranë 2006.

**MIRATOI**

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof. dr. Romeo HANXHARI**

*Tiranë, 2016*